

Emergjenca civile

Ky sektor ka për detyrë punën e përditshme për përballimin e emergjencave civile.

Përgjegjës i emergjencës civile 1. Përgjegjësi i këtij sektori/drejtorie ndjek në vijimësi çdo emergjencë që mund të krijohet, si: nga përmbytja, djegia e banesave, rrëshqitja masive, tërmetet, akte terroriste etj.

2. Ai, i ndihmuar nga nënpunësit dhe inspektorët përgjegjës të emergjencave civile mbajnë evidencë të plotë mbi masat që zbatohen për kapërcimin e emergjencës civile dhe në mbyllje të saj, informojnë me shkrim titullarin (Kryetarin e Bashkisë).

3. Përgatit materiale informuese, relacione ose projekt-vendime për miratim në Këshillin e Bashkisë, për përballimin e fatkeqësive dhe emergjencave civile.

4. Mban lidhje të vazhdueshme me sektorët homologë të institucioneve lokale dhe rajonale (Bashki, Këshillin e Qarkut, institucionin e Prefektit) për planizimin e bashkërendimin e punëve për rastet e emergjencave.

5. Në rastet e emergjencave nga më të ndryshmet dhe në çfarëdo lloj kohe, drejtorët e drejtorive, administratorët e njësive administrative, policia Bashkiake përbëjnë gjithnjë grupin e punës për përballimin e situatave të krijuara.

6. Sipas rastit, grupi i punës i emergjencave civile kryesohet nga Kryetari i Bashkisë ose titullari më i lartë pas këtij të fundit (nënkryetari, sekretari i përgjithshëm ose administratori i njësisë ku është krijuar situata emergjente), ndërsa nuk do të mungojnë në asnjë rast drejtori i emergjencave civile (ose përgjegjësi nëse kemi të bëjmë me sektor dhe jo drejtori), drejtorët e drejtorive të mirëmbajtjes së rrugëve, bujqësisë, shërbimeve dhe pyjeve.

7. Punonjësit duhet të jenë me uniformë gjatë shërbimit të tyre.

8. Këta të fundit janë të detyruar që të vënë në shërbim të zgjidhjes së situatës emergjente të gjithë ose një pjesë të nënpunësve që kanë në drejtoritë që drejtojnë.

9. Përfaqëson institucionin në mbledhje e seminare për çështjet që lidhen me menaxhimin e Emergjencave Civile, si dhe informon eprorin/Kryetarin për gjithçka diskutohet apo përfitohet në këto tryeza. Zbaton me profesionalizëm dhe rigorozitet Ligjin nr. 8756, "Për Emergjencat Civile", i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, që lidhen me Emergjencat Civile. Nën drejtimin e eprorit direkt dhe në bashkëpunim me drejtuesit e drejtorive të tjera të Bashkisë Prrenjas dhe Administratorët e Njësive Administrative, harton përshkrimet e punës për të gjithë specialistët/inspektorët si dhe përcakton kritere të veçanta për çdo funksion në përputhje me strukturën organike. Përshkrimet e punës rishikohen, plotësohen dhe përmirësohen sa herë që shihen të nevojshme nga eprorët/drejtimesit.

10. Ka përgjegjësi të plotë për mirëmbajtjen dhe saktësinë e dosjeve, ruajtjen e kufidencialitetit.

11. Plotëson dosjet me dokumentat përkatëse sipas VKM nr 329. Ruan kufidencialitetin e të dhënave, pasi mban dhe administron dosjet përkatëse për çdo rast ku është bërë verifikimi bazuar në Ligjin 8756 "Emergjencia Civile" dhe V.K.M. 329, "Për kriteret e procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmëve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore.

12. Përgatija e shkresave dhe kërkesave të ardhura nga qytetarët dhe kryrjen e verifikimi në familje.

13. Planimizimi dhe përballimi i emergjencave civile që synon ,parandalimin ,pakësimin dhe riaftësimin nga çdo dëmtim që prek popullatën, gjënë e gjallë ,pronën ,trashgimin kulturore dhe mjedisin nga emergjencat civile. Garantimin e përdorimit e të gjitha burimeve të mundshme të shtetit me qëllim sigurimin publik.

Specialist i emergjencës civile duhet të sigurojë zbatimin e dispozitave ligjore për emergjencat civile, dhe të marrë masa për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në objektet që ka në administrim ose në pronësi Bashkia Prrenjas.

2. Të kërkojë dhe japë në raste zjarresh masive, emergjencash e fatkeqësish të tjera, ndihmë me automjete, pajisje e personel.

3. Të zbatojë masat e sigurisë që parandalojnë fatkeqësitë e ndryshme natyrore si dhe të ndihmojë në kapërcimin e tyre duke u dhënë gjithashtu ndihmë të dëmtuarve në raste urgjence;

4. Të zbatojë detyrat e caktuara nga eprori direkt ne zbatim të kuadrit ligjor per emergjencat civile.